

AKT THEMELIMI

I

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“GF SERVICE” Shpk

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 24/03/2023, ne themeluesit , **GIANLUCA SPENNATO , FABIO SPENNATO dhe SOKOL ÇELAJ**, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**GF SERVICE**” Shpk. Kjo shoqëri themelohet në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjin Nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme

Themeluesit e kompanisë :

- **GIANLUCA SPENNATO**, Lindur në Melissiano (LE) , më 06.12.1974, me Nr. passaporte **CA55728GY** banues në Itali.
- **FABIO SPENNATO**, Lindur në Melissiano (LE) , më 11.11.1963, me Nr. Passaporte **CA76466EY** , banues në Itali.
- **SOKOL ÇELAJ** , Lindur në Vlorë , më 31.05.1988, me Nr. Id **I80531122P**.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë si më poshtë :

- Qira makinash, Qira, Shitje, Import - eksport, Shërbim transferimi Ekskursioni, Transport njerëzish dhe gjëra tregtare të mobiljeve të palëvizshme. Restorant Bar- Pizzeria. Shërbimet e argëtimit publik. Shërbime të ndryshme.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kompanisë do të jetë në një periudhë pa afat.

Neni 4:

Selia

Selia e kompanisë është në adresën: “Lagjja Pavarësia, Pranë Portit Detar Vlorë, Terminali i Pasagjerëve, Nr5, Vlorë”.

Me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj dhe për të hapur degë dhe filiale të tjera në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë mund të krijojë, modifikojë apo të anultojë seli sekondare agjensi dhe përfaqësi kudo që e quan të nevojshme edhe jashtë shtetit.

Neni 5

Kapitali themeltar

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në 3 kuota, në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

Kapital financiar 100,000 lekë.

1. Ortak, Themelues: **GIANLUCA SPENNATO** zotërues i 1 (një) kuote, në masën 34 % me vlerë 34,000 Leke.
2. Ortak, Themelues: **FABIO SPENNATO** zotërues i 1 (një) kuote, në masën 33 % me vlerë 33,000 Leke
3. Ortak, Themelues: **SOKOL ÇELAJ** zotërues i 1 (një) kuote, në masën 33 % me vlerë 33,000 Leke

Neni 6:

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë
Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë caktohet : **Emanuela Çelaj**, Lindur ne Vlore, ne 21.03.1994, banuese ne: Lagjja 24 Maji, Rruga Vasil Kalo, Vlore dhe me numer personale J45321099T.

(Emër, Mbiemër, Firmë):

Emanuela Çelaj
[Firmë]

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GF SERVICE"

GIANLUCA SPENNATO

[Firmë]

SOKOL ÇELAJ

FABIO SPENNATO

[Firmë]